



Pranuar / Dorezuar Punileno/Prodato Received/Delivered	26. 05 / 2021	viti god year	1
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSACK	2651/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.270/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.270/2021 të datës 13.04.2021, të parashtruara nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Lulzim Osmani", nr.18, Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.270/2021 e datës 13.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi në pozitën "përkthyes shqip-serbisht dhe anasjelltas" në Divizionin për Personel dhe Administratë pranë Policisë së Kosovës, me datë 12.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1735/2021 të regjistruar me A.nr.270/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që ti njihet e drejta e kompensimit të shujtës ditore dhe pagës së 13-të (për vitet 2018, 2019 dhe 2020) nga hyrja në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 11.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën me numër prot:2325/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit A.nr.270/2021 me numër protokolli 1735/2021 e datës 13.04.2021 me shkresat e bashkangjitura 1/23; E-mailin e datës 12.04.2021 dërguar nga _____ për _____ Kontratën e ankuesit të datës 16.07.2013 me numër reference:07/1-01A/0097; Vërtetimin për punësim në Policinë e Kosovës i datës 12.04.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 26.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 15.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 15.01.2018; faqen numër 30 dhe 31 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.04.2021 më numër protokolli:1874/2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 11.05.2021 më numër prot:2325/2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën përkthyes në Policinë e Kosovës; E-maili i datës 22.04.2021 dërguar nga _____ për _____ me shkresat e bashkangjitura prej (2) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratës së Punë të datës 16.07.2013, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "përkthyes shqip-serbisht dhe anasjelltas", në Divizionin e Personelit dhe Administratës pranë Policisë së Kosovës.

Ankuesi me datë 12.04.2021 ka parashtruar kërkesë në Sektorin e Administratës dhe Personelit të Policisë së Kosovës, për kompensimin e shujtës ditore dhe pagës së 13-të (për vitet 2018, 2019 dhe 2020) duke ju referuar Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Sektori i Administratës dhe Personelit të Policisë së Kosovës, me datë 12.04.2021 i është përgjigjur në kërkesë ankuesit, duke njoftuar të njëjtin së Drejtoria e Personelit është jo kompetente për të vendosur lidhur me kërkesën e parashtruar nga ankuesi. Pas kësaj përgjigje ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 i njehë të drejtën e pagesës së shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë (13), për vitin 2018, 2019 dhe 2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimi Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 3 paragrafi 5 me të cilin është përcaktuar se: *Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës ... i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi*, si dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 të këtij ligji, ku është përcaktuar se: *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë*, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se stafi civil në Policinë e Kosovës, kanë statusin e nëpunësit civil, dhe të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit të aplikueshëm për Shërbimin Civil.

Ketë konstatim, Kolegji e mbështet edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në pikën 211 që përcakton se: *...në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ka analizuar edhe Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 02 mars 2012, përkatësisht nenin 47 paragrafi 2, 3, dhe 4 ku përcaktohet se: 2. *Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathhtësi të veçanta.* 3. *Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Benificionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe benificionet e pensionit.* 4. *Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.* Në këtë kuptim, Kolegji ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesta, kompensimet dhe benificionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, siç përcaktohet me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës, andaj, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, duke u thirrur në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, kurse me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Neni 20 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar kompensimet e nëpunësve civil përtej pagës, duke paraparë se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paafësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit; 8 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës; 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare; 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren; 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune.* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se stafi civil në Policinë e Kosovës, mund të realizoj vetë kompensimet përtej pagës të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke u bazuar në nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i zbatueshëm nga datë 09.07.2020), ka konstatuar së Ligji për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimi Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, që nënkupton edhe dispozitat e ligjeve të veçanta, përjashtimisht Institucioneve të Pavarura Kushtetuese. Me tej neni 18 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*. Andaj në këtë kuptim, Kolegji konstaton se marrëdhënia e punës e stafit civil në Policinë e Kosovës, rregullohet me dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.270/2021

Flakron GASHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.